



In medias res

FAZAT NËPËR TË CILAT KALOJNË NDRYSHIMET NË ARSIM (4)

Faza e parë e ndryshimit siç kemi thënë në shkrimet e kaluara lidhet me konstatimin-diagnostifikimin apo skanimin e gjendjes reale në arsim. Në këtë vlerësim, revizion apo skanim konstatohen pikat e "forta"- gjërat e mira në sistemin e arsimit. Ato përforcohen dhe nxiten. Për hir të qëndrueshmërisë së ndryshimeve ato evidentohen, arsyetohen. Me fjalë të tjera bëhet një katalog apo inventar i pikave të forta të arsimit si dhe një sërë masash të cilat përcaktohen dhe të cilat duhet të arsyetohen dhe të diskutohen me qëllim që këto pika të forta të mund të zhvillohen dhe avancohen më tej.

Në diagnostifikim, po ashtu, konstatohen "pikat e dobëta ". Pikat e dobëta të sistemit të arsimit janë ato fusha ku nuk ka arritje, përkatësisht janë ata faktorë të cilët sistemin e arsimit e bëjnë joefikas dhe joefektiv. Këto mund të jenë: mos-përfshirja, braktisja e sistemit të arsimit, tekstet e dobëta, kurrikulat që favorizojnë dijet deklarative dhe teorike në dëm të dijeve procedurale dhe praktike, mësimdhënia tradicionale, sistemi i dobët i përgatitjes së personelit arsimor, statusi i pavolitshëm profesional dhe social i punëtorëve të arsimit, udhëheqja dhe qeverisja jofunksionale dhe autoritare, centralizimi enorm i sistemit të arsimit i cili shndërrohet në fyt të ngushë dhe behet pengesë për krijimin e hapësirave për punë kreative dhe mobile të punëtorëve të arsimit; sistemi i dobët i planifikimit, monitorimit dhe i vlerësimit të arritjeve të nxënësve dhe të institucioneve arsimore dhe të mësimdhënësve; mungesa e sistemit të përparimit të mësimdhënësve në karrierë mbi bazën e performancës së arritur; ekzistimi i strukturave të shumta arsimore jo funksionale dhe jo mobile dhe me detyra të njëjta apo të ngjashme; ekzistimi i dy sistemeve paralele arsimore që mund të prodhojnë konflikte të bazuara në identitete etnike; sistemi dhe infrastruktura jo e plotë legjislative; vetëdija jo e plotë për zbatimin dhe respektimin ligjeve dhe të ligjshmërisë; politizimi i skajshëm i arsimit duke bërë përzgjedhjen e udhëheqjes mbi bazat e përcaktimit partiak e jo të kriterëve të meritës, përkushtimit, dhe të etosit; autonomia e ngushtuar e institucioneve e arsimore; mungesa e standardeve me të cilat përcaktohen pritshmëri të larta dhe të avancuara, institucionet e arsimit nuk janë organizata të fuqishme të nxënësve dhe të prodhimit të dijeve të reja etj.

Pikat e këtyra të dobëta vendosen në një katalog apo inventar për to dhe mbi to zhvillohet një debat konstruktiv me qëllim të identifikimit të masave dhe aktiviteteve për ndryshime pozitive si dhe për përcaktimin agjentëve të ndryshimit.

Në fazën e parë po ashtu konstatohen edhe mundësitë dhe kushtet që duhet të krijohen për fuqizimin mëtejshëm të pikave të forta, si dhe për transformimin e pikave të dobëta në pika të forta.

Në këtë fazë analizohen edhe rreziqet e mundshme dhe pengesat dhe kufizimet të cilat mund të paraqiten sipas pikave të identifikuar

Sipas Teorisë së ndryshimeve në arsim agjent i ndryshimit mund të jetë çdo njeri, sepse nga efektet arsimore duhet të ketë përfitime secili njeri. Për këtë arsye, disa herë në këto shkrime për ndryshimet në arsim kemi përsëritur mendimin se edukimi dhe arsimit janë interes nacional dhe njerëzor i secilit qytetarë. Ky konstatim është me rëndësi të madhe sepse në procesin e ndryshimeve duhet të nisemi nga kjo premisë themelore.

Përshkrimi i aktiviteteve sipas programeve

Mendimi Kritik gjatë Leximit dhe Shkrimit – MKLSH

■ Më 4-5 korrik dhe 11-12 korrik është mbajtur seminari i parë dhe i dytë në kuadër të programit të MKLSH për 43 mësime të shkollave fillore dhe të mesme të Komunës së Obiliqit. Seminari i tretë me titull “Leximi, Shkrimi dhe Diskutimi në çdo lëndë” është mbajtur më 29-30 gusht 2009. Ky trajnim financohet nga Drejtorati Komunal i Obiliqit.

Krijimi i mjediseve të sigurta, jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe shkolla


■ Është themeluar Komiteti Rajonal për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës në Gjakovë. Po ashtu janë themeluar pesë Komitete Komunale për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijës në këto komuna: Gjilan, Mitrovicë, Pejë, Prizren dhe Gjakovë. Janë mbajtur 8 takime me përfaqësuesit e DKA-ve në Gjakovë, Prizren, Pejë, Mitrovicë.

■ Me UNICEF është nënshkruar një Aneks i kontratës me qëllim të vazhdimit të Projektit deri me datën 31 dhjetor 2009, periudhë kjo e monitorimit dhe të vlerësimit të ndryshimeve pozitive në 168 shkolla pilot, në pesë komunat e përfshira.

■ Në Pejë gjatë muajit gusht 2009 është bërë prezantimi i projektit në Aktivin drejtorëve të shkollave fillore dhe të mesme të ulëta. Është hartuar edhe Plani i veprimit për monitorimin dhe vlerësimin e efekteve të prodhuara nga zbatimi i projektit. Po ashtu në këtë

komune janë shpërndarë 28 Kutitë për të Drejtat e Fëmijës.

■ Këto ditë ka dal nga shtypi edhe Doracaku për Krijimin e Mjedisve të Sigurta, jo të dhunshme dhe humane në shoqëri dhe në shkolla.



Trajnim për Edukimin multikulturor

■ Trajnimi i Mësimeve të Shkencave Humanitare dhe të Zyrtarëve të Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë të Arsimit të Lartë të Mesëm për edukimin multikulturor. Projekti është financuar nga Shoqata e Arsimit të Rriturve të Kosovës.



■ Në trajnim janë përfshirë 18 mësime të ndryshme. Temat që janë trajtuar gjatë

trajnimin janë mirëpritur nga pjesëmarrësit dhe janë vlerësuar shumë lart trajnerët. Në fletëvlerësimet e këtij trajnimi nga pjesëmarrësit është sugjeruar që trajnime të tilla të organizohen anekënd Kosovës.

Gjatë muajit gusht është shkruar raporti (shih: www.childrights-ks.org)

Hap pas Hapi

- Në kuadër të projektit “Sigurimi i Cilësisë në Zhvillimin e Edukimit të Fëmijërisë së Hershme” është organizuar trajnimi me 32 drejtor të shkollave fillore të rajonit të Prishtinës. Trajnimi kishte për qëllim ngritjen e kapaciteteve të drejtorëve për “Monitorim të punës së mësimdhënësve”, e që është pjesë e projektit. Pjesëmarrësit vlerësuan se ky trajnim është shumë i domosdoshëm dhe i mirëseardhur për punën e tyre. Me datën 30 shtator dhe 14 tetor drejtorët e shkollave të cilët morën pjesë në këtë trajnim do të monitorojnë në praktikë. Kjo praktikë do të zhvillohet në shkollën fillore “Hilmi Rakovica” në Prishtinë.

- Në kuadër të këtij projekti do të trajnohen 300 drejtor, pedagog të shkollave fillore dhe institucioneve parashkollore, si dhe zyrtar të arsimit. Trajnimi i radhës mbahet në Pejë me datat 29, 30 gusht dhe 1 shtator.

KOSOVISION Contest

- Në kuadër të projektit KOSOVISION CONTEST, janë duke u bërë përgatitjet për fillimin e vitit të ri të këtij projekti. Kontrata e vitit të dytë të projektit është nënshkruar në mes të KEC dhe Universitetit të Edukimit në Cyrih, të Zvicrës, me këtë rast edhe kontratat e

stafit lokal për punën në vitin e dytë të këtij projekti janë përgatitur dhe janë nënshkruar. Tani jemi në fazën e mbledhjes së informatave nga Drejtoritë Komunale të Arsimit në tërë Kosovën, rreth numrit të mësimdhënësve dhe nxënësve të cilët do të jenë pjesë e këtij projekti. Edhe këtë vit, ky projekt do të përkrahët nga MASHT dhe me këtë rast janë duke u bërë përgatitjet për një Konferencë për media, ku Ministri i Arsimit, Z. Enver Hoxhaj do të ketë mundësinë që ti ftoj të gjitha shkollat e Kosovës të bëhen pjesë e projektit KOSOVISION CONTEST 2.

Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e arsimit

- Në kuadër të këtij projekti “Promovimi i të drejtave të fëmijës në fushën e arsimit”, financuar nga Komisioni Evropian, po zhvillohet sipas dinamikës së projektit. Gjatë këtyre dy muajve është punuar në draftimin e Kornizës së Monitorimit. Tani janë duke u bërë edhe përgatitjet për punëtorinë e fundit në të cilën edhe do të bëhet finalizimi i kësaj Kornize. Po ashtu gjatë këtyre dy muajve është punuar edhe në manualin për të drejtat e fëmijës, të cilin manual do ta shfrytëzojnë nxënësit në aktivitetet e tyre shkollore por për të cilat aktivitete do të trajnohen.

Avancimi i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grupeve të pakicave etnike në arsim

Gjatë muajve korrik dhe gusht në kuadër të projektit “Avancimi i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grupeve të pakicave etnike në arsim” janë zhvilluar këto aktivitete:

■ Më 6-7 korrik në Bruksel u mbajt konferenca “Konsolidimi i partneriteteve në mes të organizatave të shoqërisë civile dhe autoriteteve publike për ngritjen e të drejtave të pakicave në regjion” e organizuar nga Komisioni Evropian. Në kuadër të projektit APREME morën pjesë 4 përfaqësues të cilët u zgjodhën gjatë bisedës në mes të koordinatorëve të shteteve pjesëmarrëse në projekt. Përfaqësuesit ishin Jehona Shala nga KEC - Kosovë, Eli Pijaca nga NEPC - Kroaci, Snjezana Mrse nga MOST-Serbi dhe Esad Bratovic nga proMENTE - Bosnjë dhe Hercegovinë. Në konferencë u prezantuan 8 projekte rajonale të financuara nga Komisioni Evropian, mundësitë e bashkëpunimit dhe çështje logjistike.

■ Janë bërë të gjitha përgatitjet e nevojshme për organizimin e takimit të parë të hulumtuesve në kuadër të komponentës 2 të Projektit “Hulumtimet Kombëtare” që do të zhvillohet me 1 dhe 2 shtator. Në takim do të marrin pjesë nga një hulumtues nga Kosova, Shqipëria, Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, dhe Kroacia, si dhe dy përfaqësues nga Rumania dhe një nga Britania e Madhe në cilësinë e ekspertëve nga Bashkësia Evropiane.

Prevention on Peer Violence

■ Gjatë këtyre dy muajve janë bërë përgatitjet për fazën e dytë të projektit. Trajnimi për trajnerë do të mbahet në shtator dhe tani është duke u bërë edhe përkthimi i manualit për pjesën e dytë të këtij trajnimi. Raporti gjashtëmujor për realizimin e këtij projekti është dërguar tek donatori.

Avancimi i komunikimit me prindër në shkollat e Kosovës

■ Në kuadër të projektit “Avancimi i komunikimit me prindër në shkollat e Kosovës” janë zhvilluar metodologjia dhe procedurat për avancimin e komunikimit me prindër në 6 shkolla të Kosovës si rezultat i punëtorisë 2 ditore që u mbajt gjatë qershorit me përfaqësues të shkollës dhe prindërve. Gjithashtu u kontaktuan shkollat dhe u caktuan datat e përafërta për prezantimin e metodologjisë dhe procedurave para mësimdhënësve të këtyre shkollave nga ana e KEC.

Access Microscholarship Program

■ Po bëhen përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor në kuadër të programit Access Microscholarship Program. Do të vazhdohet puna me dy grupe në Prishtinë dhe një në Prizren. Planifikohet që mësimi të fillojë në pjesën e dytë të shtatorit.

Përgatiti: Petrit Tahiri